



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 07, datë 08.02.2017

PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA KORÇË

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 58 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 671, datë 29.07.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Bashkisë Korçë, si dhe referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 9, datë 25.01.2017, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Korçë, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtëm:
 - a) Strategjia Territoriale, shoqëruar me përmbledhjen e Analizës dhe Vlerësimit të Territorit;
 - b) Plani i Zhvillimit të Territorit, shoqëruar me Shtojcën I, sipas përcaktimeve të Rregullores së Planifikimit;
 - c) Rregullorja e Planit;
 - d) Vlerësimi Strategjik Mjedisor;
 - e) Materiali hartografik:
 - i. Vizioni strategjik;
 - ii. Ndarja e territorit në 5 sisteme;
 - iii. Ndarja e territorit në njësi;
 - iv. Përdorimi i propozuar i tokës sipas 14 kategorive bazë;
 - v. Infrastruktura e transportit;
 - vi. Fazat e zbatimit të PPV-së.
2. Autoriteti përgjegjës për miratimin e Planeve të Detajuara për Zonat me Rëndësi Kombëtare është Këshilli Kombëtar i Territorit, me propozim të Ministrit përgjegjës.

3. Gjatë hartimit të Planeve të Detajuara Vendore, projekteve strategjike, projekteve pilot të zhvillimit, si dhe çdo projekti tjetër për zhvillimin e territorit, Bashkia Korçë duhet të bazohet në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga Plani i Përgjithshëm Vendor.
4. Ngarkohet Bashkia Korçë për zbatimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, si dhe për bashkërendimin e punës në zbatim të këtij plani me AKPT-në, Ministrinë përgjegjëse dhe të gjitha autoritetet e tjera shtetërore, sipas fushave të përgjegjësisë.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohen studimet urbanistike/dokumentet e planifikimit të miratuara më parë nga KRRTRSH/KKT për territorin administrativ të Bashkisë Korçë, përfshirë si më poshtë:
 - Vendim Nr. 3, datë 04.02.1994 i KRRTRSH-së “Për planin rregullues dhe vijën kufizuese të qytetit të Korçës”;
 - Vendim Nr. 1, datë 19.02.2003 i KRRTRSH-së “Për detyrën e projektimit për studimin urbanistik të qendrës së qytetit të Korçës dhe vijës kufizuese të kësaj qendre”;
 - Vendim Nr. 7, datë 22.05.2007 i KRRTRSH-së “Për miratimin e ndryshimit të Planit Rregullues të qytetit të Korçës, në lidhje me ndryshimin në zonimin funksional për disa zona të qytetit”;
 - Vendim Nr.13, datë 07.03.2014 i KKT-së “Për miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë”.
6. Planet e Detajuara Vendore dhe lejet e ndërtimit të miratuara në zbatim të dokumenteve të planifikimit të mëparshme, të cilave nuk u ka mbaruar afati i zbatimit, mbeten në fuqi.
7. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRREJTARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMEZI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETAR I KKT

LEDA TOTA

DREJTOR I AGENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

